



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec
Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

Njësia e Auditimit të Brendshëm

01 Nr. 3888
Rahovec me 13.12.2019

 REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot. 3888 Më 13.12 2019
Br. prot. Dt. 13.12 2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORTI VJETOR

Lënda: RAPORTI VJETOR I PUNËS TË NJAB.

Për periudhën 01.01 - 31.12.2019.

(i formës së shkurtër)

DATA: . 01.12.2019

Raporti i punës të NJAB-së për periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2019

Në kuadër të këtij viti, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin Vjetor të punës për vitin 2019, i cili Planë ka qenë i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.

Ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin për Auditim të Brendshëm (LAB), Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit të Brendshëm.

Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për vitin 2019, janë të planifikuara 10 Auditime.

Prej tyre në periudhën Janar -Dhjetor të vitit 2019, janë kryer dhjetë (10) auditime, sipas planit vjetor, kurse dy Auditime janë kryer sipas kërkesës të Kryetarit të Komunës.

Në tabelën e mëposhtme do të paraqiten të gjitha auditimet të planifikuara dhe të kryera për periudhën 01.01 gjërë 12.12.2019, sipas Planit Vjetor dhe sipas shkallës së rrezikshmërisë.

N.r.	Drejtoritë e synuara të auditimit të Planifikuara dhe të realizuara për vitin 2019	Shkalla e rrezikshmërisë sipas Planifikimit
1	Auditimi i Brendshëm Ad-Hoc në Drejtoritë: Financa dhe buxhet, Shëndetësi dhe mirëqenie sociale, Ekonomi-zhvillim dhe turizëm dhe Gjeodezi-kadastër dhe pronë. - Realizimi i të hyrave vetanake - Dhënja e vërtetimeve	Rrezik i Lartë 8 Rekomandime
2	Auditimi i Brendshëm në Drejtorin Komunale të Arsimit. Realizimi i të Hyrave dhe Shpenzimet	Rrezik i Lartë 6 Rekomandime
3	Auditimi i Brendshëm Ad-Hoc në Drejtoritë: Urbanizmit, Planifikimit Hapsinor dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe Administratës së Përgjithshme - Realizimi i të hyrave vetanake - Dhënja e vërtetimeve	Rrezik i Lartë 4 Rekomandime
4	Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural Realizimi i të Hyrave dhe Shpenzimet	Rrezik i Mesëm 4 Rekomandime
5	Auditimi i brendshëm në zyrën e Personelit Mirëmbajtja e dosjeve të personelit;	Rrezik i mesëm 1 Rekomandim
6	Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Shërbime Publike, Komunale. - Menagjimi i Projekteve - Inkasimi dhe Realizimi i të hyrave vetanake	Rrezik i mesëm 5 Rekomandime

7	Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Ekonomi dhe Zhvillim • Të hyrat nga Qiraja e pronës komunale • Menaxhimi i të hyrave nga tarifat ngarkesat e subjekteve afariste • Menaxhimi dhe mirëmbajtja e Pasurisë	Rrezik i Lartë 6 Rekomandime
8	Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Urbanizëm, Planifikim Hapsinor dhe Mbrojtje të Mjedisit. • Menaxhimi i të hyrave nga taksat për lëshimin e lejeve për ndërtim dhe rregullimin e tokës ndërtimore. • E tjera	Rrezik i Lartë 4 Rekomandime
9	Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Administratë të Përgjithëshme • Menaxhimi i të hyrave nga shërbimet administrative • Menaxhimi dhe mirëmbajtja e automjeteve	Rrezik i mesëm 4 Rekomandime
10	Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale • Menaxhimi i të hyrave nga Participimi. • Menaxhimi i Përsoneelit • Menaxhimi i barnave esanciale	Rrezik i mesëm 5 Rekomandime
11	Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Financa dhe Buxhet • Menaxhimi i proceseve të tatimit në pronë • Shpenzimet	Rrezik i Lartë 3 Rekomandime
12	Auditimi i brendshëm në Zyrën e Prokurimit • Zbatimi i procedurave prej inicimit të aktivitetit të prokurimit e deri tek përmbartimi i kontratës publike, në pajtueshmëri me kërkesat e ligjit të prokurimit publik.	Rrezik i Lartë 7 Rekomandime

Vlerësimi i objektivave për auditime sipas shkallës së rrezikshmërisë është bërë në Planin Strategjik të NJAB-së për vitet 2019 – 2021, planë ky i aprovuar po ashtu nga Kryetari i Komunës.

Aktivitetet dhe angazhimet e tjera të Njesisë së Auditimit të Brendshëm :

- Në periudhën janar - Dhjetor, angazhimet tona në auditim kryesisht kanë qenë në Realizimin e të hyrave vetanake, Shpenzimet dhe lëshuarja e vërtetimeve të tatimit në pronë.
- Si aktivitete tjera mund të cekim ofrimin e ndihmave profesionale të vazhdueshme për të gjitha Drejtoritë Komunale që kanë shfaqur interesim dhe nevojë, lidhur me të kuptuarit e rreziqeve, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e tyre, duke e krijuar një regjistër me rreziqe të identifikuar ashtu që menaxhmentet gjegjëse të kenë më lehtë të ushtrojnë kontrollet gjegjëse adekuate për minimizimin e çdo rreziku që mund të jetë pengesë për zbatimin e objektivave të Drejtorive.
- Gjithashtu NJAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e Raportimit për implementimin e rekomandimeve.

Vlerësimi përmbyllës:

Në këtë periudhë janar - Dhjetor të vitit 2019 NJAB-ja ka arritur objektivat e planifikuara me Planin Vjetor, me që ka arritur ti kryej Dhjetë (10) auditime, dhe dy (2) auditime ad-hoc (me kërkesë të Kryetarit) të cilat kanë pasur një fushveprim mjaftë të gjërë dhe kompleks.

Në secilin auditim të kryer, pos të gjeturave menaxhmentit të Drejtorisë së audituar, ju është dhënë rekomandime për përmirësimin e proceseve dhe sistemeve, duke u bërë në vazhdimësi përcjellja e zbatueshmërisë së atyre rekomandimeve. Pra është arritur të krijohet një bashkpunim produktiv në mesë NJAB-së dhe menaxhmenteve komunale.

Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit janë gjithsej: 57 rekomandime, të cilat priten të implementohen.

Nga Menaxhmenti i lartë të Komunës dhe Menaxhmenti i Drejtorive Komunale, kërkohet një angazhim më i madh për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga Auditimet e Brendëshme.

per. Drejtori i NJAB-së: 